

FTESË PËR OFERTË

Emri: Linja e Keshillimit per Gra dhe Vajza
Adresa: Rr. "Muhamet Gjollësia", H.4, Ap.8, Tirane
E-mail: linjaekeshillimit@gmail.com
Afati i dorëzimit të ofertës: 23.08.2019

Linja e Keshillimit per Gra dhe Vajza po zbaton projektin "Fuqizimi ekonomik i viktimave të dhunës në familje dhe aktivizimi i të rinjve kundër dhunës" në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Prendimor (ReLOaD), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), duke mbështetur bashkitë në zhvillimin e mekanizmave transparente të financimit për OSHC-të, në mënyrë që të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët në komunitetin lokal. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti organizata kërkon të prodhojë dhe transmetojë një radio spot me qëllim ndergjegjesues për publikun.

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë ofertën e tyre siç parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më 23.08.2019, në adresën e e-mailit: linjaekeshillimit@gmail.com

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Linja e Keshillimit per Gra dhe Vajza do të zhvillojë procedurën e prokurimit për produktet dhe shërbimet sipas përshkrimeve në tabelën e mëposhtme.

Nr	Përshkrimi i mallit/shërbimit/	Çmimi/njësi Me TVSH
1	Prodhim spoti radiofonik 30 sekonda	
3	98 (nëntëdhjetë e tetë) transmetime të spotit radiofonik	

Specifikime të përgjithshme teknike:

Radio spoti duhet të ketë një kohëzgjatje prej 30 sekondash.

Kushte të përgjithshme:

- 1) Preferohen subjektet e regjistruar me aktivitet në Tirane dhe të ketë objekt shërbimet e kërkuara

- 2) Dorëzimi i ofertës do të bëhet vetëm nëpërmjet email në adresën e organizatës linjaekeshillimit@gmail.com brenda datës 23.08.2019

Nuk pranohen ofertat dorazi.

- 3) Paga e subjektit kryhet me transfertë bankare, nëpërmjet bankes Raiffeisen, pas marrjes së shërbimit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit. Gjithashtu ofertuesit, krahas Ofertës financiare të plotësuar, e cila duhet të jetë në ALL dhe TVSH të përfshihet në kosto/çmim, duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

- 1) Licencën për ushtrimin e aktivitetit / Ekstraktin e QKB të marre deri një ditë para postimit të ofertes;
- 2) Ofertën financiare për çdo produkt sipas tabelës më sipër;
- 3) Numrin e llogarisë bankare.

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njohet për të nënshkruar kontratën.
